


**ANALIZË GJINORE DHE INTERSEKSIONALE E
POLITIKAVE, PROGRAMEVE DHE SHËRBIMEVE
NË FUSHAT E ARSIMIT, SHËNDETËSISË DHE
MBROJTJES SOCIALE NË KOMUNËN E
GOSTIVARIT**





Titulli: Analizë gjinore dhe interseksionale e politikave, programeve dhe shërbimeve në fushat e arsimit, shëndetësisë dhe mbrojtjes sociale në Komunën e Gostivarit

Autor: Edita Arslani

Botues: Shoqata për sigurimin e shërbimeve sociale – Socio

Analiza gjinore dhe interseksionale e politikave, programeve dhe shërbimeve në fushat e arsimit, shëndetësisë dhe mbrojtjes sociale në komunën e Gostivarit është përgatitur në kuadër të projektit përmes nën-grantit „Mundësi të barabarta për të gjithë: Politika lokale me integrim gjinor“, i cili zbatohet në kuadër të projektit „**Nga mosnjohja e dallimeve drejt komuniteteve lokale transformuese që e njohin diversitetin dhe barazinë inkluzive**“, i implementuar nga **Unioni – Këshilli Nacional për Barazi Gjinore**, në partneritet me **Polio Plus – Lëvizja kundër hendikepit** dhe **Asociacionit për Iniciativa Demokratike (ADI)**, ndërsa financohet nga **Delegacioni i Bashkimit Evropian në Republikën e Maqedonisë së Veriut**.

Përmbajtja e kësaj analize është përgjegjësi ekskluzive e SOCIO dhe autorit, dhe në asnjë rrethanë nuk mund të konsiderohet se pasqyron qëndrimet e Bashkimit Evropian.

PËRMBAJTJA



_Toc224610872	Abstrakt	4
1.	HYRJJE	5
1.1.	FUSHA Të DISKRIMINIMIT	5
1.2.	Diskriminim i shumëfishtë	6
1.3.	Interseksionalitet dhe qasje interseksionale	6
2.	HARTË SOCIO – EKONOMIKE E KOMUNËS SË GOSTIVARIT	7
2.1.	Lokacioni, popullsia dhe struktura demografike	7
2.1.2.	KONTEKSTI RAJONAL DHE EKONOMIK	9
2.1.3.	Tregu i punës	10
3.	Qëllimi dhe metodologjia	11
3.1.	Qëllimi i hulumtimit	11
3.2.	METODOLOGJIA E HULUMTIMIT	11
4.	ANALIZË GJINORE SEKTORIALE ME QASJE INTERSEKSIONALE	12
4.1.	ARSIM	12
4.2.	MBROJTJA SOCIALE	14
4.2.1.	QENDRA NDËRKOMUNALE PËR PUNË SOCIALE – GOSTIVAR	14
4.2.2.	QENDRA PUBLIKE PËR KUJDES PARASHKOLLOR	14
4.2.3.	Qendra Ditore për Persona me nevoja të Vecanta	15
4.2.4.	STREHIMORJA PËR VIKTIMAT E DHUNËS NË FAMILJE	15
4.2.5.	Shoqata për sigurimin e shërbimeve Sociale - SOCIO	16
4.2.6.	SHOQATA Homecare	18
4.3.	SHËNDETËSIA	19
5.	Analiza e politikave, programeve dhe masave në tri fushat e studimit për vitin 2025 nga perspektiva gjinore dhe me qasje interseksionale	20
5.1.	Analiza e Programit për aktivitete në fushën e mundësive të barabarta për gratë dhe burrat për vitin 2025	20
5.2.	Analiza e programit për aktivitetet në fushën e mbrojtjes sociale, shëndetësore dhe të fëmijëve për vitin 2025	22
5.3.	Analiza e programit për aktivitetet në fushën e sektorit të veprimtarive publike, Departamenti për mbrojtjen shëndetësore, sociale dhe të fëmijëve, dhe mbrojtjen dhe shpëtimin e qytetarëve dhe pasurive për vitin 2025.	24
5.4.	ANALIZA E PROGRAMIT TË AKTIVITETEVE NË FUSHËN E ARSIMIT NË VITIN 2025	26
5.	Analiza e përdoruesve (Anketa me qytetarët)	29
	Përfundime	41
	REKOMANDIME	42

ABSTRAKT

Kjo analizë gjinore ka për qëllim të identifikojë dhe të analizojë pabarazitë gjinore dhe interseksionale në qasjen ndaj shërbimeve dhe burimeve publike në Komunën e Gostivarit, me fokus në tri fusha prioritare: arsim, shëndetësi dhe mbrojtje sociale, për periudhën 2025–2026. Analiza bazohet në një desk-analizë të dokumenteve përkatëse nacionale dhe lokale, të dhënave statistikore, programeve buxhetore, si dhe të dhënave primare të mbledhura përmes pyetësorëve dhe anketave me përfaqësues të institucioneve dhe përdorues të shërbimeve.

Komuna e Gostivarit karakterizohet me një strukturë multietnike dhe demografikisht të larmishme, me përfaqësim pothuajse të barabartë të grave dhe burrave në popullsinë totale. Megjithatë, analiza tregon se kuadri formal ligjor dhe institucional për barazinë gjinore nuk është integruar në mënyrë të mjaftueshme dhe sistematike në proceset e planifikimit, zbatimit dhe buxhetimit të politikave lokale.

Një gjetje kyçe është përdorimi i pamjaftueshëm i të dhënave të ndara në bazë gjinore dhe interseksionale në të tri fushat. Në arsim, edhe pse ekzistojnë të dhëna sipas përkatësisë etnike dhe shpërndarjes territoriale, nuk mblidhen në mënyrë sistematike të dhëna të ndara sipas gjinisë për nxënësit. Kjo kufizon mundësinë për një analizë gjithëpërfshirëse gjinore. Indirekt vjen në shprehje se shpërndarja e fondeve në shkollat lokale dhe institucionet parashkollore bëhet pa përdorimin e të dhënave të ndara gjinore, përkatësisht nuk mirret parasysh aspekti gjinor, as qasja interseksionale. Nga aspekti interseksional, si masë e vetme, respektivisht qëllim në programin arsimor është evidentuar mbledhja e të dhënave për nxënësit që udhëtojnë nga zonat rurale. Në mbrojtjen sociale ekziston një rrjet relativisht i zhvilluar shërbimesh, duke përfshirë mbështetjen për viktimat e dhunës në familje dhe shërbime për kujdes në shtëpi, por këto shërbime zakonisht fokusohen në aspektin gjinor, respektivisht janë sensitive, por pa integruar qasje të thellë interseksionale. Sektori i shëndetësisë përballet me sfidat më të mëdha – mungesë e të dhënave të ndara në bazë gjinore dhe interseksionale, si dhe kufizime strukturore (përfshirë edhe mungesën një aparati mamografie), gjë që ka ndikim të drejtpërdrejtë mbi ofrimin e shërbimeve shëndetësore të aksesueshme në kohë dhe me cilësi për gratë.

Analiza e programeve lokale për vitin 2025 tregon se, edhe pse janë parashikuar disa aktivitete të orientuara drejt avansimit të barazisë gjinore, ato shpesh nga aspekti gjinore formulohen si neutrale dhe nuk përmbajnë tregues të qartë për matjen e ndikimit mbi nëngrupe të ndryshme të grave dhe burrave. Buxhetimi i përgjegjshëm gjinor nuk është i integruar plotësisht në ciklin buxhetor, ndërsa mbledhja e të dhënave gjinore shpesh parashikohet si aktivitet pasiv (eks post) dhe jo si pjesë e planifikimit strategjik.

Grupet veçanërisht të cënueshme janë gratë nga zonat rurale, romet femra, nënat beqare, gratë me aftësi të kufizuara dhe gratë me status socio-ekonomik të ulët, për të cilat nuk janë mjaftueshëm të njohura në programet dhe masat ekzistuese.

Në përfundim, analiza tregon se është e nevojshme kalimi nga një qasje deklarative dhe me ndjeshmëri (sensitive) gjinore drejt një qasjeje sistematike, me buxhetim të përgjegjshëm gjinor dhe interseksional në krijimin dhe zbatimin e politikave lokale. Kjo nënkupton vendosjen e mbledhjes dhe analizës së detyrueshme të të dhënave të ndara në baza gjinore, forcimin e kapaciteteve institucionale, integrimin e perspektivës gjinore në buxhetim dhe zhvillimin e masave të targetuara për gratë dhe vajzat me forma të ndryshme të cenueshmërisë, me qëllim sigurimin e një qasjeje të drejtë dhe të barabartë ndaj shërbimeve publike për të gjithë qytetarët e Komunës së Gostivarit.

1. HYRJE

Barazia gjinore nënkupton që sjelljet, aspiratat, nevojat dhe prioritetet e ndryshme të grave dhe burrave të respektohen, të merren parasysh, të vlerësohen dhe të mbështeten në mënyrë të barabartë. Ajo do të thotë se të drejtat, përgjegjësitë dhe mundësitë e individëve nuk varen nga fakti nëse janë lindur si gra apo burra, por nga nevojat dhe potencialet e tyre reale.

Barazia gjinore është një vlerë themelore e rendit socio-politik të Republikës së Maqedonisë së Veriut. Kushtetuta garanton liri dhe të drejta të barabarta për të gjithë qytetarët dhe qytetaret, pa dallim gjinie, race, ngjyre të lëkurës, prejardhjeje kombëtare dhe sociale, bindjes politike dhe fetare, si dhe statusit pasuror dhe shoqëror. Ky parim është përcaktuar në nenin 9 të Kushtetutës, i cili parashikon se të gjithë qytetarët janë të barabartë para Kushtetutës dhe ligjeve.

Në sistemin ligjor të Republikës së Maqedonisë së Veriut, diskriminimi është i ndaluar me ligje të ndryshme që sigurojnë mbrojtje nga trajtimi i pabarabartë. Sipas Ligjit për parandalimin dhe mbrojtjen nga diskriminimi, çdo dallim, përjashtim, kufizim ose dhënie privilegji bazuar në arsye diskriminuese, qoftë me veprim apo mosveprim, që ka për qëllim ose rezulton në pengimin ose pamundësimin e njohjes, shfrytëzimit ose realizimit të të drejtave dhe lirive të një individi ose grupi, konsiderohet diskriminim. Ky ligj përfshin të gjitha format e diskriminimit, duke përfshirë pamundësimin e përshtatjes së duhur, si dhe mungesën e aksesit dhe paaftësinë për të përdorur infrastrukturën, mallrat dhe shërbimet.¹

1.1. FUSHA TË DISKRIMINIMIT

Diskriminimi mund të manifestohet në fusha të ndryshme të jetës shoqërore dhe publike dhe të krijojë pabarazi strukturore dhe barriera për grupe të ndryshme të grave dhe burrave. Shpesh, ai

¹ KNBG, Polio Plus dhe ADI, *Udhëzues për qasje interseksionale gjinore*, 2025.

nuk shfaqet në mënyrë të izoluar, por ndërthuret nëpër disa fusha, gjë që rrit edhe më shumë cenueshmërinë e grupeve të caktuara.

Disa nga fushat kryesore ku mund të shfaqet diskriminimi janë:

- a) **Arsim** – Diskriminimi në sistemin arsimor mund të manifestohet përmes aksesit të kufizuar në institucione arsimore, ndihma mësimore dhe materiale didaktike, përmes paragjyqimeve dhe stereotipeve nga stafi arsimor, ndarjes fizike të nxënësve dhe nxënësve bazuar në arsye diskriminuese (segregim), mungesës së aksesit në shkolla dhe moshësigurimit të përshtatjes së duhur. Për më tepër, ai mund të reflektohet edhe përmes pritshmërive dhe mundësive të ndryshme arsimore për grupe të ndryshme nxënësish dhe nxënës.
- b) **Shëndetësi** – Në sistemin shëndetësor, diskriminimi mund të rezultojë në akses të kufizuar ose të pabarabartë në shërbimet shëndetësore, cilësi të ndryshme të kujdesit shëndetësor, si dhe mungesë kuptimi dhe mbështetje për nevojat specifike shëndetësore të grupeve të ndryshme. Kjo përfshin gjithashtu mungesën e aksesit në institucionet shëndetësore dhe mos-sigurinë e përshtatjes së duhur për personat me aftësi të kufizuara ose me nevoja të tjera specifike.
- c) **Shërbimet publike dhe mbrojtja sociale** – Aksesit i kufizuar në shërbimet publike dhe sistemet e mbrojtjes sociale godet veçanërisht grupet e marginalizuara dhe të cenueshme, duke përfshirë gratë, personat me aftësi të kufizuara, të moshuarit dhe anëtarët e komuniteteve më të vogla etnike. Këto barriera mund të çojnë në kushte më të pafavorshme të jetesës, rritje të varfërisë dhe thellim të përjashtimit social.

1.2. DISKRIMINIM I SHUMËFISHTË

Për një kuptim të plotë të pabarazive dhe praktikave diskriminuese në shoqëri, është e nevojshme të merret parasysh fakti se individët shpesh nuk përballen me diskriminim vetëm mbi një bazë, por mbi disa baza njëkohësisht. Në këtë drejtim, Ligji për parandalimin dhe mbrojtjen nga diskriminimi e përcakton diskriminimin e shumëfishtë si diskriminim që realizohet mbi dy ose më shumë baza diskriminuese. Mund të ndodhë në periudha të ndryshme kohore për secilën bazë diskriminuese, ose mund të ndodhë njëkohësisht, dhe në këtë rast quhet *diskriminim kumulativ*, ku efektet e bazave të ndryshme nuk janë thjesht të mbledhura, por ndërveprojnë dhe forcojnë njëra-tjetrën, duke krijuar forma më të ndërlikuara dhe më të thella të përjashtimit dhe pabarazisë.²

1.3. INTERSEKSIONALITET DHE QASJE INTERSEKSIONALE

² KNBG, Polio Plus dhe ADI, ANALIZA PËR QASJEN INTERSEKSIONALE GJINORE, 2025.



Interseksionaliteti përbën një koncept dhe kornizë analitike që mundëson një kuptim më të thellë të mënyrave se si identitetet e ndryshme shoqërore ndërthuren dhe krijojnë përvoja komplekse të diskriminimit dhe forma të njëkohshme të shtypjes. Këto përvoja bazohen në dy ose më shumë karakteristika identiteti, respektivisht baza diskriminuese, si gjinia, përkatësia etnike, aftësitë, mosha, vendbanimi dhe statusi socio-ekonomik.

Interseksionaliteti tregon se individët dhe grupet nuk përballen me diskriminim vetëm mbi një bazë, por shpesh me forma të shumëfishta, të ndërlidhura dhe përforcuese të pabarazisë. Edhe pse legjislacioni dhe politikat zakonisht i njohin identitetet e grave dhe burrave në mënyrë individuale, në realitet përvojat e, për shembull, një gruaje rome, një gruaje me aftësi të kufizuara ose një gruaje nga zona rurale, janë ndjeshëm më të ndryshme dhe më komplekse se ato të grave që nuk përballen me këto barriera shtesë.


Qasja interseksionale është thelbësore për identifikimin dhe adresimin e këtyre formave komplekse të diskriminimit. Njohja e bazave të ndryshme diskriminuese dhe e fushave ku diskriminimi manifestohet përbën një hap të domosdoshëm drejt krijimit të politikave publike më gjithëpërfshirëse, të drejtë dhe efektive, të cilat i përgjigjen nevojave reale të të gjithë qytetarëve.

Gjatë kryerjes së një analize gjinore interseksionale, është e rëndësishme të merren parasysh faktorët e ashtuquajtur ndihmës interseksional. Këta faktorë ndihmojnë në përballimin e pasojave të ndërthurjes së sistemeve të ndryshme të pushtetit, si patriarkati, racizmi, homofobia, abelizmi dhe forma të tjera të pabarazisë strukturore, dhe mundësojnë shfrytëzimin e diversitetit si një burim për përmirësimin e të drejtave të njeriut për grupet e cënueshme dhe të marginalizuara.³

2. HARTË SOCIO – EKONOMIKE E KOMUNËS SË GOSTIVARIT

2.1. LOKACIONI, POPULLSIA DHE STRUKTURA DEMOGRAFIKE

³ KNBG, Polio Plus dhe ADI, *Udhëzues për qasje interseksionale gjinore*, 2025.



Komuna e Gostivarit ndodhet në Rajonin e Pologut të Republikës së Maqedonisë së Veriut, ndërmjet komunave Mavrovë dhe Rostushë, Brvenicë, Vrapçisht, Kërçovë dhe Makedonski Brod. Komuna zë një sipërfaqe prej rreth 650 km², përfaqëson një mjedis tipik multikulturor, ku jetojnë pothuajse të gjitha kombësitë e Republikës së Maqedonisë së Veriut (maqedonas, shqiptarë, turq, romë dhe të tjera). Rrethi i komunës së Gostivarit shquhet për një natyrë të pasur, një pozitë gjeografike të favorshme, mbi 500 metra mbi

nivelin e detit, dhe është i rrethuar nga dy kështjella natyrore, Mali i Sharrit dhe Mali i Thatë.⁴

Qyteti shtrihet në rajonin e Pologut (Pologu i Epërm) në një lartësi prej 510 metrash mbidetare. Afër Gostivarit, në fshatin Vrutok (5 km jugperëndim nga Gostivari), ndodhet burimi i lumit më të madh në Maqedoni, Vardar, i cili kalon edhe nëpër qytet duke e ndarë atë në dy pjesë. Po ashtu, afër tij ndodhet parku më i madh nacional dhe qendra për skijim Mavrovë. Gostivari ndodhet 67 kilometra larg Shkupit, ndërsa qytetet fqinje janë Tetova 27 kilometra në veri dhe Kërçova 46 kilometra në jug. Gostivari është një qytet që po zhvillohet me ritëm të shpejtë dhe po bëhet një nga qytetet më të bukura të Republikës së Maqedonisë së Veriut. Komunën e përbëjnë: qyteti Gostivar dhe fshatrat: BalinDol, Turcan i madhë, Brodec, Vërtok, Banjica e Epërme, Jelovca e Epërme, Gjenovica e Epërme, Debresh, Banjica e Poshtme, Jelovca e Poshtme, Gjenovica e Poshtme, Zdunjë, Koritë, Kunovë, Lakavicë, Lešnica, Turçan i vogël, Mirdita, Mitroj Krsti, Padalisht, Peçkovë, Simnicë, Sërmnovë, Sushicë, Strajan, Raven, Reçan, Tërnov, Tumçevisht, Qafë, Forinë, Çajlë dhe Çegranë.⁵

Sipas të dhënave zyrtare nga Regjistrimi i Popullsisë 2021, Komuna e Gostivarit ka gjithsej 59,770 banorë. Në Komunën e Gostivarit, përqindja e burrave dhe grave është pothuajse e barabartë, me një diferencë prej vetëm 1% në favor të grave. Në tabelën më poshtë paraqitet numri i popullsisë i ndarë sipas gjinisë.

	Gjithsej	Burra (numër/%)	Gra (numër/%)
Popullsia gjithsej	59 770	29 321 (49,05%)	30 449 (50,94%)

⁴ Finance Think – Instituti për Hulumtime dhe Politika Ekonomike, *Ndikimi i pandemisë COVID-19 mbi buxhetimin gjinor në Komunën e Gostivarit*, Shkup, 2021.

⁵ Amidiu, N., dhe Memeti, M., *Analizë interseksionale gjinore e politikave për mbrojtje sociale nga perspektiva e personave me aftësi të kufizuara dhe grupeve të tjera të cënueshme në Komunën e Gostivarit për vitin 2023*, Gostivar, 2021.

Tabela 1: Popullsia totale sipas gjinisë⁶

Në lidhje me strukturën etnike të popullsisë, Komuna e Gostivarit karakterizohet nga një larmi e theksuar, ku dominon popullsia me përkatësi etnike shqiptare. Kjo shumëllojshmëri kulturore dhe sociale përbën një sfidë të rëndësishme për administratën lokale, e cila ka detyrimin të sigurojë një cilësi të mirë të jetës për të gjithë qytetarët, duke marrë parasysh gjininë e tyre, si dhe njëkohësisht të përgjigjet ndaj nevojave dhe specifikave të ndryshme të popullsisë në segmentet e ndryshme të jetës së përditshme.

Përkatësi etnike	Numri gjithsej	Gjithsej Përqindje	Burra Numri	Burra Përqindje	Gra numri	Gra Përqindje
Popullsia totale	59 770		29 321	49.05%	30 449	50.94%
Maqedonas	12 807	21.42%	6342	49.51%	6465	50.48%
Shqiptarë	33 076	55.33%	16 126	48.75%	16 950	51.24%
Turq	7 597	12.71%	3789	49.87%	3808	50.12%
Romë	2 273	3.80%	1144	50.32%	1129	49.67%
Vllahë	17	0.02%	10	58.82%	7	41.17%
Serbë	73	0.12%	36	49.31%	37	50.68%
Boshnjak	25	0.04%	7	28%	18	72%
Të tjerë të papërmendur	487	0.81%	237	48.66%	250	51.33%
Nuk janë deklaruar	2	0.003%	1	50%	1	50%
E panjohur	4	0.006%	3	75%	1	25%
Personat për të cilët të dhënat janë marrë nga burime administrative	3409	5,70%	1626	47,69%	1783	52,30%

Tabela 2: Popullsia sipas gjinisë dhe përkatësisë etnike⁷

2.1.2. KONTEKSTI RAJONAL DHE EKONOMIK

⁶ Burimi: Enti Shtetëror i statistikave, Regjistrimi i popullsisë, amëvisrive dhe banesave në R.M.V, viti 2021 https://www.stat.gov.mk/publikacii/2022/POPIS_DZS_web_MK.pdf

⁷ Burimi: Enti Shtetëror i statistikave, Regjistrimi i popullsisë, amëvisrive dhe banesave në R.M.V, viti 2021 https://www.stat.gov.mk/publikacii/2022/POPIS_DZS_web_MK.pdf

Komuna e Gostivarit ndodhet në Rajonin e Pologut, i cili në një kontekst më të gjerë rajonal shënon pjesëmarrjen më të ulët në Prodhimin e Brendshëm Bruto (PBB) të Republikës së Maqedonisë së Veriut – 6.8% të PBB-së totale. Zhvillimi ekonomik i rajonit është i ngadalësuar për shkak të disa faktorëve strukturor, ndër të cilët dallohen: emigracioni i intensifikuar, humbja e fuqisë punëtore të kualifikuar, transformimi i vonuar struktural i ekonomisë dhe të ardhurat e ulëta nga investimet direkte të huaja. Këto kushte e vështirësojnë modernizimin dhe kufizojnë mundësitë për rritje të punësimit dhe zhvillim ekonomik, duke rezultuar në një nivel të lartë të papunësisë.

2.1.3. TREGU I PUNËS

Sipas të dhënave të Agjencisë për Punësim të RMV – Gostivar, në fund të vitit 2025, në Komunën e Gostivarit ishin të regjistruar gjithsej 6,510 persona të papunë, respektivisht kërkues për punë. Analiza e të dhënave nga perspektiva gjinore tregon ekzistencën e dallimeve gjinore në papunësi, ku 3,404 persona ishin gra dhe 3,106 persona burra, gjë që tregon një pozicion disi më të pafavorshëm të grave në tregun lokal të punës, duke pasur parasysh veçanërisht shkallën e tyre më të ulët të aktivitetit ekonomik dhe pjesëmarrjen në punësimin formal.

Në kuadër të përgatitjes së kësaj analize, përmes qasjes së drejtpërdrejtë dhe bashkëpunimit me Agjencinë për Punësim të Republikës së Maqedonisë së Veriut, u konstatua se institucioni, përveç të dhënave të ndara sipas gjinisë, disponon edhe të dhëna nga një perspektivë interseksionale. Kjo do të thotë se situata e kërkuesve për punë mund të analizohet gjithashtu sipas faktorëve të tjerë relevantë, si përkatësia etnike, niveli i arsimit dhe vendbanimi.

Dallimet gjinore dhe interseksionale të identifikuara në tregun e punës përbëjnë një kontekst kyç për analizën e situatave në fushat e arsimit, shëndetësisë dhe mbrojtjes sociale. Këto të dhëna mundësojnë një kuptim më të thellë të faktorëve strukturorë që formësojnë pabarazitë në qasjen ndaj shërbimeve publike dhe përbëjnë një bazë të rëndësishme për planifikimin e politikave lokale të përgjegjshme gjinore dhe të ndjeshme interseksionale në këto tri fusha studimi.

	Национална припадност	Вкупно		НКВ		ПКВ и НСО		КВ		ВКВ		ССО		ВИШЕ СО		ВИСОКО СО		Магистри		Доктори	
		Се	Жени	Се	Жени	Се	Жени	Се	Жени	Се	Жени	Се	Жени	Се	Жени	Се	Жени	Се	Жени	Се	Жени
1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12	13	14	15	16	17	18	19	20	21	22
1	Албанци	4006	2131	3109	1726	15	6	107	6	0	0	576	268	2	1	170	111	26	13	1	0
2	Македонци	872	454	191	98	5	2	85	33	0	0	467	241	9	7	107	69	8	4	0	0
3	Турци	715	365	474	279	3	2	28	1	0	0	175	61	3	2	29	18	1	1	2	1
4	Роми	641	313	562	282	5	4	13	1	0	0	60	26	0	0	1	0	0	0	0	0
5	Муслимани	268	137	203	115	1	0	12	1	0	0	49	20	0	0	2	1	1	0	0	0
6	Срби	5	3	2	1	0	0	0	0	0	0	2	1	0	0	1	1	0	0	0	0
7	Словенци	1	0	1	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
8	Бугари	1	0	0	0	0	0	0	0	0	0	1	0	0	0	0	0	0	0	0	0
9	Бошњаци	1	1	1	1	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
10	Други	0	0	0		0		0		0		0		0		0		0		0	
	Вкупно	6510	3404	4543	2502	29	14	245	42	0	0	1330	617	14	10	310	200	36	18	3	1

Табела 4: Përmbledhje e personave të papunë në Gostivar sipas përkatësisë etnike dhe nivelit të arsimit, me gjendje - 31.12.2025⁸

3. QËLLIMI DHE METODOLOGJIA

3.1. QËLLIMI I HULUMTIMIT

Qëllimi i kësaj analize gjinore interseksionale është t'i identifikoj pabarazitë gjinore dhe sfidat kryesore në qasjen ndaj shërbimeve në tri fushat e studimit në nivel lokal: arsim, shëndetësi dhe mbrojtje sociale në Komunën e Gostivarit.

Vëmendje e veçantë është dhënë përcaktimit të shkallës së integritit të perspektivës gjinore dhe qasjes interseksionale në politikat lokale, praktikën dhe proceset buxhetore në këto tri fusha studimi.

Qëllimi përfundimtar i analizës është të sigurojë një bazë të rëndësishme, të argumentuar dhe të përshtatshme për planifikimin, përmirësimin dhe zbatimin e politikave, programeve dhe masave të përgjegjshme gjinore dhe të ndjeshme interseksionale në fushat e arsimit, shëndetësisë dhe mbrojtjes sociale në Komunën e Gostivarit.

3.2. METODOLOGJIA E HULUMTIMIT

Hulumtimi është realizuar duke përdorur një qasje metodologjike të kombinuar, cilësore dhe sasore, e cila mundëson një shqyrtim të gjithanshëm të pabarazive gjinore dhe interseksionale. Kombinimi i të dhënave nga të dyja këto burime është veçanërisht i rëndësishëm kur aplikohet një qasje interseksionale, pasi mundëson një kuptim më të thellë të realizimit të të drejtave të njeriut tek gratë nga grupet e cënueshme dhe të marginalizuara, si dhe identifikimin e ndikimeve komplekse të sistemeve të ndryshme të pushtetit që ndërthuren.

Desk Analizë – Është kryer një analizë e detajuar e dokumenteve ligjore, strategjike dhe programore relevante në nivel nacional dhe lokal, të cilat parashikojnë detyrime për njësitë e qeverisjes lokale në fushën e barazisë gjinore dhe buxhetimit të përgjegjshëm gjinor. Analiza përfshiu aktet e brendshme, politikat dhe programet e miratuara nga Komuna e Gostivarit për vitin 2025, si dhe statistikat zyrtare të disponueshme nga institucionet relevante për fushat e studimit.

Janë shqyrtuar dokumentet e mëposhtme:

- Programi i aktiviteteve të Komunës së Gostivarit në fushën e mundësive të barabarta për gratë dhe burrat (2025)

⁸ Burimi: Agjencioni për punësim i RMV – së – Gostivar.

- Programi i aktiviteteve të Komunës së Gostivarit në fushën e mbrojtjes sociale, shëndetësore dhe të fëmijëve (2025)
- Programi i aktiviteteve të Komunës së Gostivarit në fushën e arsimit (2025)
- Analiza e të dhënave statistikore të disponueshme nga institucionet relevante

Shënim: Analiza bazohet në një analizë dokumentare të programeve vjetore të Komunës së Gostivarit, të cilat nuk janë publikuar si dokumente të veçanta në faqen e internetit të Komunës, por janë pjesë e gazetave zyrtare. Kjo praktikë e vështirëson qasjen dhe analizën e plotë të tyre, si dhe nuk e përjashton mundësinë e mosidentifikimit të qëllimshëm të të gjitha programeve relevante. Prandaj, rekomandohet që Komuna e Gostivarit të përmirësojë transparencën duke publikuar të gjitha programet vjetore në një seksion të veçantë dhe lehtësisht të aksesueshëm në faqen e saj të internetit.

Të dhënat primare u mbledhën përmes:

- Pyetësorë gjysmë-strukturuar dhe intervista me persona kontakt të nominuar nga komuna, koordinatoren e KMB-it, si dhe përfaqësues të institucioneve publike nga fushat e arsimit, shëndetësisë dhe mbrojtjes sociale
- Anketim online i qytetarëve dhe përdoruesve të shërbimeve; në këtë mënyrë, politikat e komunës matën bazuar në përvojat e titullarëve – përdoruesve të të drejtave, duke përfaqësuar një qasje transformuese gjinore

Analiza e të dhënave dhe buxhetimi i përgjegjshëm gjinor – Të dhënat e mbledhura nga të gjitha burimet (analiza dokumentare, anketa, pyetësorë dhe diskutime) janë sistematizuar dhe analizuar nga një perspektivë gjinore dhe interseksionale.

Kjo analizë përpiket të përcaktojë pikët fillestare, në mënyrë që krijuesit e politikave dhe akterët e tjerë të përfshirë të kenë një bazë fillestare, përkatësisht një këndvështrim interseksional, për planifikimin e masave të ardhshme.

4. ANALIZË GJINORE SEKTORIALE ME QASJE INTERSEKSIONALE

4.1. ARSIM

Arsimi në Komunën e Gostivarit ofrohet përmes 10 shkollave fillore dhe 4 shkollave të mesme. Në vitin shkollor 2025/2026, në shkollat fillore të Komunës së Gostivarit janë regjistruar 5.434 nxënës, ndërsa në shkollat e mesme janë regjistruar gjithsej 2.881 nxënës.⁹ Burimi i këtyre të dhënave është Sektori i Arsimit pranë Komunës së Gostivarit. Sektori ka dorëzuar të dhëna të

⁹ Burimi: Sektori për arsim në Komunën e Gostivarit..

ndara sipas shkollave dhe përkatësisë etnike të nxënësve, por nuk ekzistojnë të dhëna të sistematizuara dhe të aksesueshme të ndara sipas gjinisë.

Duke pasur parasysh që të dhënat janë dorëzuar për secilën shkollë ndaras, brenda kësaj analize është e mundur të bëhet ndarja indirekte e të dhënave sipas zonës urbane dhe rurale, bazuar në vendndodhjen e shkollave fillore, gjë që paraqitet në tabelën më poshtë.

Megjithatë, duhet të theksohet se mungesa e të dhënave të sistematizuara të ndara sipas gjinisë përbën një kufizim të rëndësishëm për realizimin e një analize të plotë gjinore në arsimin në nivel lokal. Kjo tregon për integritet të pamjaftueshëm institucional të perspektivës gjinore në proceset e planifikimit, monitorimit dhe vlerësimit të politikave arsimore në Komunën e Gostivarit.

Nga ana tjetër, ekzistenca e të dhënave të ndara sipas përkatësisë etnike lejon një analizë të pjesshme interseksionale, veçanërisht në lidhje me identifikimin e mundësive të ndryshme të aksesit në arsim mes komuniteteve etnike të ndryshme. Për më tepër, mundësia për klasifikimin e shkollave sipas zonës urbane dhe rurale mundëson analizimin e pabarazive territoriale në arsimin lokal.

Lloji i shkollës	Shqiptarë	Maqedonas	Turq	Romë	Tjerë	Gjithsej numri
Shkollat fillore	3.056	1.300	804	271	3	5.434
Shkollat e mesme	1547	780	554	/	/	2.881

Tabela 5: Përmbledhje e numrit total të nxënësve në shkollat fillore dhe të mesme, me shpërndarje sipas përkatësisë etnike

Lloji i shkollës	Mjedis urban	Mjedis rural	Gjithsej numri
Shkolla fillore	3.830	1.604	5.434

Tabela 6. Numri total i nxënësve në shkollat fillore sipas vendbanimit

Në të njëjtin vit shkollor, në arsimin fillor në Gostivar janë të punësuar 744 mësimdhënës/e, prej të cilëve shumica, 515, janë mësimdhënës, ndërsa 229 janë mësimdhënës meshkuj. Në shkollat e mesme në Gostivar janë të punësuar gjithsej 394 mësimdhënës/e, prej të cilëve 217 (55%) janë gra dhe 177 (45%) janë burra.

4.2. MBROJTJA SOCIALE

Mbrojtja sociale në Komunën e Gostivarit sigurohet përmes një rrjeti të institucioneve publike dhe organizatave të licencuara qytetare, të cilat veprojnë në koordinim me Komunën dhe Ministrinë e Politikës Sociale, Demografisë dhe Rinisë.

Institucione publike:

- Qendra ndërkomunale për punë sociale – Gostivar
- Qendrës publike për kujdes parashkollor
- Qendrës ditore për persona me nevoja të veçanta

Organizata të licencuara qytetare:

- SOCIO – sigurimin e shërbimeve për ndihmë dhe kujdes në shtëpi
- HOMECARE – sigurimin e shërbimeve për ndihmë dhe kujdes në shtëpi
- ETIKA – Strehimore për viktimat e dhunës në familje

4.2.1. QENDRA NDËRKOMUNALE PËR PUNË SOCIALE – GOSTIVAR

Qendra për punë sociale Gostivar është një qendër ndërkomunale me kompetenca për komunitetin Gostivar, Mavrovë dhe Rostushë dhe Vrapçishtë. Qendra siguron shërbime të mbrojtjes sociale, informim, udhëzime, ndihmë dhe këshillim profesional, si dhe realizimin e të drejtave financiare nga mbrojtja sociale, kryesisht bazuar në ndihmën minimale të garantuar dhe shtesën për ndihmë dhe kujdes nga një person tjetër.

4.2.2. QENDRA PUBLIKE PËR KUJDES PARASHKOLLOR

Cerdhja “Gëzimi i Fëmijëve” funksionon me pesë objekte dhe ka një kapacitet prej 864 fëmijësh, ndërsa aktualisht janë të pranuar 841 fëmijë, dhe 136 fëmijë janë në listën e pritjes për shkak të mungesës së vendeve të lira. Kjo tregon qartë nevojën për zgjerimin e kapaciteteve ekzistuese dhe hapjen e shërbimeve të reja për kujdesin e fëmijëve.

Në institucion janë të punësuar gjithsej 88 persona, prej të cilëve 84 janë gra dhe 4 janë burra. Burrat janë të angazhuar ekskluzivisht në pozicione administrative-teknike, ndërsa nuk ka asnjë burrë të punësuar si kujdestar ose staf arsimor. Kjo gjendje tregon ekzistencën e stereotipeve të rrënjësura gjinore, sipas të cilave kujdesi për fëmijët tradicionalisht perceptohet si “rol femëror”, gjë që kontribuon në një segregim të dukshëm gjinor brenda institucionit.

Nga ana tjetër, institucioni ka një funksion të rëndësishëm sensitiv gjinor, pasi ofron shërbime që janë veçanërisht të rëndësishme për aktivizimin dhe mbajtjen e nënave të fëmijëve parashkollorë në tregun e punës. Disponueshmëria e shërbimeve cilësore për kujdesin parashkollor ndikon drejtpërdrejt në mundësinë e grave për të qenë ekonomikisht aktive, duke pasur parasysh se kujdesi për fëmijët ende bie në mënyrë disproporcionale mbi shpatullat e grave, duke marrë parasysh ndikimin e normave patriarkale mbi gratë në shoqërinë tonë, veçanërisht brenda komuniteteve më të vogla etnike.

Në këtë kontekst, është e qartë mungesa e një qasjeje transformuese gjinore, e cila nuk ka si qëllim vetëm të përgjigjet ndaj nevojave ekzistuese të grave, por edhe të ndryshojë aktivisht rolet tradicionale gjinore dhe marrëdhëniet e pushtetit. Nxitja e pjesëmarrjes më të madhe të burrave në ekonominë e kujdesit, veçanërisht në sektorin formal të kujdesit parashkollor, mund të kontribuojë në zvogëlimin e perceptimeve se kujdesi për fëmijët dhe për anëtarët e tjerë të varur të familjes është detyrë ekskluzivisht femërore.

	Përkatësia etnika	Numri i fëmijëve të pranuar	Numri i fëmijëve në listën e pritjeve
	Shqiptarë	370	35
	Maqedonas	400	76
	Turq	56	15
	Romë	15	10
	Gjithsej	841	136

Tabela, nr.8: Përmbledhje e numrit të fëmijëve të pranuar dhe atyre në listën e pritjes sipas përkatësisë etnike

	Mjedis urban	Mjedis rural	Вкупно Број
	696	145	841

Tabela.nr.9: Përmbledhje e numrit të fëmijëve sipas vendbanimit

4.2.3.QENDRA DITORE PËR PERSONA ME NEVOJA TË VECANTA

Në Gostivar funksionon një qendër ditore për persona me nevoja të veçanta, **Qendra për Autizëm “Blue Puzzle”**, e cila ofron kujdes ditor dhe aktivitete zhvilluese për fëmijë dhe persona me aftësi të kufizuara.

4.2.4. STREHIMORJA PËR VIKTIMAT E DHUNËS NË FAMILJE

Në Komunën e Gostivarit funksionon një strehimore për viktimat e dhunës në familje, e cila filloi me punë në gusht të vitit 2023. Qendra u themelua me vendim të Këshillit të Komunës së Gostivarit dhe menaxhohet nga organizata joqeveritare “Etika”. Objekti ka një sipërfaqe prej rreth 105 m² dhe ka kapacitet për strehim dhe mbrojtje të përkohshme për 8–10 viktimat të dhunës në familje dhe dhunës gjinore, si dhe për fëmijët e tyre. Sipas informacionit të marrë nga koordinatoreja gjatë një vizite në terren, në momentin e përgatitjes së kësaj analize, në strehimore janë të strehuara pesë persona, ku numri i përdoruesve është i ndryshueshëm dhe varet nga rastet e paraqitura.

Stafi i strehimorës është i përbërë ekskluzivisht nga gjinia femërore. Janë të angazhuara katër persona me kohë të plotë (koordinatore – eksperte gjinore, psikologe dhe pedagoge), si dhe persona të angazhuar me kohë të pjesshme (psikoterapeute dhe juriste), dhe sipas nevojës përfshihen edhe vullnetare. Edhe pse një përbërje e tillë mund të kontribuojë në krijimin e një mjedisi të sigurt dhe të besueshëm për viktimat, ajo gjithashtu reflekton segregimin më të gjerë gjinor në sektorin e kujdesit dhe mbrojtjes sociale, ku këto profesione tradicionalisht lidhen me “rolin femëror”.

Sa i përket financimit të strehimores për vitin 2025, shuma prej 1.200.000 denarësh nga buxheti i Komunës së Gostivarit dhe 810.000 denarësh nga Ministria e Politikës Sociale, Demografisë dhe të Rinjve tregon njohjen institucionale të rëndësisë së shërbimit dhe përbën një hap pozitiv drejt sigurimit të qëndrueshmërisë së shërbimeve sensitive gjinore.

Edhe pse qendra është qartë politike e ndjeshme sensitive gjinore, analiza tregon mungesë të një qasjeje interseksionale, që do të thotë se nuk ka analizë të grupeve veçanërisht të cënueshme (nëna të vetme, gra me aftësi të kufizuara, gra rurale, gra nga komunitete etnike më të vogla).

4.2.5. SHOQATA PËR SIGURIMIN E SHËRBIMEVE SOCIALE - SOCIO

Shoqata për sigurimin e shërbimeve sociale – SOCIO është një organizatë qytetare e licencuar që ofron shërbimin social “Ndihmë dhe kujdes në shtëpi”. Ky shërbim synon të mbështesë përdoruesit në kryerjen e aktiviteteve bazë dhe instrumentale të jetës së përditshme, me qëllim përmirësimin e cilësisë së jetës së tyre dhe mundësimin e qëndrimit në ambientin e tyre shtëpiak.

Numri i të punësuarve – kujdestarë/kujdestare	Numri i personave të angazhuar me honorar	Kordinatorë/e
8	11	1
Gjithsej		20

Tabela nr.10: Stafi profesional i SOCIO-s

Sipas të dhënave të paraqitura në Tabelën 10, ekipi i SOCIO-s përbëhet ekskluzivisht nga gra. Kjo situatë, analizuar nga perspektiva gjinore, pasqyron feminizimin e lartë të sektorit të kujdesit. Një

strukturë e tillë tregon se kujdesi për personat e moshuar, personat me aftësi të kufizuara dhe personat me kapacitet funksional të reduktuar perceptohet dhe praktikohet kryesisht si punë “femërore”.

Mosha	Burra	Gra
Nën 65	1	2
65-70	1	4
71-75	3	5
76-80	3	11
81-85	4	12
Mbi - 86	5	3
Gjithsej	17	37

Tabela 11: Struktura sipas moshës dhe gjinisë e përdoruesve

Nga perspektiva e përdoruesve, gjatë vitit 2025 shoqata ka ofruar shërbimin “Ndihmë dhe kujdes në shtëpi” për gjithsej 54 përdorues. Analiza e strukturës sipas moshës dhe gjinisë së përdoruesve (Tabela 11) tregon se shërbimi përdoret kryesisht nga popullsia e moshuar. Grupi dominues i moshës është midis 81 dhe 85 vjeç, çka tregon një përfaqësim të lartë të personave në moshë të avancuar. Përdoruesi më i moshuar i SOCIO-s ka qenë 94 vjeç, ndërsa aktualisht përdoruesi më i moshuar është 91 vjeç.

Shpërndarja gjinore e përdoruesve tregon një përfaqësim të dukshëm më të madh të grave. Nga gjithsej 54 përdorues, 37 janë gra dhe 17 janë burra.

Përkatësia etnike	Maqedonas/e	Shqiptar/e	Rom/e
	48	5	1

Tabela 12: Përkatësia etnike e përdoruesve

Analiza sipas përkatësisë etnike (Tabela 12) tregon se pjesa më e madhe e përdoruesve janë Maqedonas/e (48 përdorues), ndërsa 5 janë Shqiptar/e dhe 1 përdoruese është Rom/e. Të dhënat tregojnë se shërbimi kryesisht përdoret nga grupi etnik dominues. Nga një perspektivë interseksionale, ekziston nevoja për një qasje më të madhe multi-etnike në promovimin dhe ofrimin e shërbimit, me fokus të veçantë tek komunitetet e marginalizuara, veçanërisht komuniteti rom, i cili tradicionalisht përballlet me një shkallë më të lartë të përjashtimit social.¹⁰

¹⁰ Shoqata për sigurimin e shërbimeve sociale – SOCIO, Raporti vjetor i monitorimit dhe vlerësimit të shërbimit social – ndihmë dhe kujdes në shtëpi, viti 2025.

Edhe pse shërbimi nga perspektiva e përdoruesve është sensitive gjinore, mungesa e burrave në rolin e kujdestarëve tregon një sfidë të kufizuar në sfidimin e roleve tradicionale gjinore dhe mungesën e një qasjeje transformuese gjinore në aspektin e burimeve njerëzore, ku kujdesi për personat e moshuar, personat me aftësi të kufizuara dhe personat me kapacitet funksional të reduktuar perceptohet dhe praktikohet kryesisht si punë “femërore”.

4.2.6. SHOQATA HOMECARE

Shoqata Homecare është organizata e dytë e licencuar që ofron shërbime për kujdes në shtëpi për personat mbi 65 vjeç, personat me aftësi të kufizuara dhe personat me kapacitet funksional të reduktuar. Mbështetja përfshin deri në 80 orë në muaj për çdo përdorues dhe përfshin aktivitete bazë dhe instrumentale të përditshme.

Përdoruesit e shërbimit janë banorë të komunave Gostivar dhe Vrapçishtë, ku aktualisht po shërbehen gjithsej 40 përdorues. Shërbimi ofrohet nga një ekip prej 20 kujdestarësh të trajnuar, profesionalë dhe të certifikuar, nga të cilët 15 janë gra dhe 5 janë burra.

Nga perspektiva gjinore, shoqata HOMECARE paraqet një shembull pozitiv dhe praktikë të mirë, pasi përfshin burra në një sektor që tradicionalisht perceptohet si punë “femërore”. Ky qasje mund të vlerësohet si qasje transformuese gjinore, sepse kontribuon në rishqyrtimin dhe transformimin gradual të normave dhe roleve tradicionale gjinore, si dhe në një shpërndarje më të barabartë të kujdesit midis grave dhe burrave.

Analiza e sistemit të mbrojtjes sociale në Komunën e Gostivarit tregon se, përkundër ekzistencës së një rrjeti relativisht të larmishëm të shërbimeve sociale, ato në shumicën e rasteve mund të vlerësohen si sensitive gjinore, por në masë të madhe mbeten interseksionalisht të verbra ndaj gjinisë. Kjo rrjedh nga mungesa e planeve dhe analizave të qarta interseksionale për atë se cilat nën-grupe të grave dhe vajzave targetohen me masat ekzistuese, si dhe nga njohja e pamjaftueshme grupeve veçanërisht më të cenueshme.

Shërbimet sociale në pjesën më të madhe janë të dizajnuara mbi bazën e kategorive të vetme të cenueshmërisë, si mosha ose aftësia e kufizuar, pa marrë parasysh faktin se përdoruesit, e veçanërisht gratë përdoruese, shpesh i përkasin njëkohësisht disa nën grupeve të cenueshme. Bëhet fjalë për gra viktime të dhunës në familje dhe dhunës me bazë gjinore që janë njëkohësisht nënat beqare, gra të moshuara me të ardhura të ulëta ose pa të ardhura, gra me aftësi të kufizuara, gra që ofrojnë kujdes afatgjatë dhe të papaguar për anëtarë të tjerë të familjes, si dhe gra nga komunitete të ndryshme etnike, nga zona rurale dhe nga grupmosha të ndryshme.

Nga perspektiva gjinore, është gjithashtu e rëndësishme se sektori i mbrojtjes sociale në Komunën e Gostivarit është shumë i feminizuar, si nga aspekti i përdoruesve, ashtu edhe nga aspekti i ofruesve të shërbimeve. Në këtë kontekst, shembulli i HOMECARE mund të identifikohet si praktikë e mirë që kontribuon drejt një qasjeje gjinore-transformuese.

4.3. SHËNDETËSIA

Shërbimi shëndetësor në Komunën e Gostivarit sigurohet përmes tre institucioneve publike shëndetësore: Spitali i Përgjithshëm – Gostivar dhe dy shtëpi të shëndetit, në kuadër të të cilave ofrohet kujdes shëndetësor parësor dhe preventiv.

Bazuar në gjendjen e konstatuar përmes pyetësorëve të realizuar me personat përgjegjës në këto institucione, mund të konkludohet se sektori i shëndetësisë paraqet një nga segmentet më të dobëta nga aspekti i analizës gjinore dhe interseksionale. Problem kyç paraqet mungesa e mbledhjes dhe përpunimit sistematik të të dhënave të ndara sipas gjinisë, e aq më pak sipas bazave të tjera relevante (mosha, vendbanimi, përkatësia etnike, aftësia e kufizuar etj.).

Përmes kërkesës për qasje në informata me karakter publik janë siguruar vetëm të dhëna të agreguara për strukturën e të punësuarve në Spitalin e Përgjithshëm – Gostivar. Sipas informatave të marra, me vendim pune janë të angazhuar 453 persona, prej të cilëve 153 janë burra dhe 300 gra, ndërsa me kontratë në vepër janë të angazhuar gjithsej 40 persona (13 burra dhe 27 gra). Këto të dhëna, edhe pse tregojnë një feminizim të theksuar të sektorit të shëndetësisë, nuk janë të mjaftueshme për realizimin e një analize thelbësore gjinore, e sidomos interseksionale, pasi nuk janë të lidhura me llojin e vendeve të punës, repartet, si dhe as me përdoruesit e shërbimeve shëndetësore.

Mungesa e mbledhjes dhe analizimit të të dhënave të ndara sipas gjinisë dhe karakteristikave të tjera sociale tregon se këto institucione lokale aktualisht nuk zbatojnë qasje interseksionale në planifikimin dhe përmirësimin e shërbimeve shëndetësore. Kjo e kufizon ndjeshëm mundësinë për të identifikuar nevojat specifike të grupeve të ndryshme të grave dhe burrave, veçanërisht të atyre më të cenueshme.

Për më tepër, si problem serioz strukturor është identifikuar edhe fakti se pothuajse katër vite në Spitalin e Përgjithshëm – Gostivar nuk funksionon aparati i mamografisë. Aktualisht, diagnostikimi i sëmundjeve të gjirit kryhet vetëm përmes ekzaminimit me eho, për shkak të mungesës së aparatit të mamografisë. Megjithatë, kontrolli me eho nuk mund ta zëvendësojë mamografinë, sidomos në kontekstin e zbulimit të hershëm të kancerit të gjirit. Sipas mendimeve profesionale mjekësore, ndryshimet në gji shpesh zbulohen dukshëm më vonë përmes ekzaminimit me eho, përkatësisht në faza më të avancuara të sëmundjes, kur mundësitë për trajtim të suksesshëm dhe mbijetesë janë dukshëm më të vogla.

Kjo gjendje e kufizon drejtpërdrejt qasjen e grave në mbrojtje shëndetësore parandaluese dhe diagnostikuese në kohë, dhe paraqet rrezik të konsiderueshëm për shëndetin publik, sidomos duke pasur parasysh rëndësinë e zbulimit të hershëm të kancerit të gjirit. Mungesa e kësaj shërbimi i prek edhe më shumë gratë nga zonat rurale dhe ato me status më të ulët socio-ekonomik, të cilat shpesh nuk kanë mundësi të përdorin shërbime shëndetësore jashtë komunës.

5. Analiza e politikave, programeve dhe masave në tri fushat e studimit për vitin 2025 nga perspektiva gjinore dhe interseksionale

5.1. ANALIZA E PROGRAMIT PËR AKTIVITETE NË FUSHËN E MUNDËSIVE TË BARABARTA PËR GRATË DHE BURRAT PËR VITIN 2025

Mundësitë e barabarta ndërmjet grave dhe burrave në Republikën e Maqedonisë së Veriut rregullohen me Kushtetutën dhe me Ligjin për mundësi të barabarta ndërmjet grave dhe burrave, me çka vendoset korniza ligjore për promovimin dhe avancimin e tyre në nivel nacional dhe lokal.

Me qëllim të sigurimit të mundësive të barabarta për gratë dhe burrat, banorë të Komunës së Gostivarit, dhe në përputhje me Ligjin për mundësi të barabarta ndërmjet grave dhe burrave (neni 14), komuna ka detyrim që në kuadër të programeve, planeve dhe strategjive vjetore të përfshijë parimin e barazisë gjinore dhe të kontribuojë në mënyrë aktive në promovimin dhe avancimin e mundësive të barabarta. Përmes kompetencave të saj dhe përmes koordinimit me institucionet lokale dhe palët e interesuara, vetëqeverisja lokale ka rol të rëndësishëm në ndërmarrjen e masave konkrete për zvogëlimin e pabarazive gjinore dhe ndërtimin e një shoqërie më inkluzive dhe më të drejtë.

Në këtë drejtim, në vitin 2005 në Komunën e Gostivarit është formuar Komisioni për Mundësi të Barabarta (KMB), roli themelor i të cilit është monitorimi dhe avancimi i zbatimit të parimeve të barazisë gjinore në nivel lokal. Aktualisht, KMB në Komunën e Gostivarit përbëhet nga pesë anëtarë, prej të cilëve katër janë gra dhe një është burrë, të gjithë anëtarë të Këshillit të Komunës. Përveç kësaj, në përputhje me kornizën ligjore, komuna ka caktuar koordinator/e dhe zëvendës-koordinator/e për mundësi të barabarta ndërmjet grave dhe burrave nga radhët e nëpunësve administrativë.

Me qëllim të pasurimit të analizës me gjetje kualitative, është realizuar edhe një anketë me koordinatoren për mundësi të barabarta në Komunën e Gostivarit, në përputhje me një pyetësor gjysmë-të strukturuar të përgatitur paraprakisht. Qëllimi i anketës ishte të sigurohen gjetje kualitative lidhur me pjesëmarrjen e koordinatorës dhe të Komisionit për Mundësi të Barabarta në procesin e përgatitjes dhe shqyrtimit të programeve vjetore lokale, me qëllim përfshirjen e parimit të mundësive të barabarta.

Edhe pse Komisioni për Mundësi të Barabarta nuk ka detyrim ligjor për përgatitjen e programeve, planeve ose strategjive të veçanta, një numër i madh komunash, përfshirë edhe Komunën e Gostivarit, praktikojnë përgatitjen dhe miratimin e këtyre dokumenteve. Në këtë drejtim, Komuna e Gostivarit ka miratuar Programin për Mundësi të Barabarta ndërmjet Grave dhe Burrave, brenda të cilit parashikohen aktivitete të caktuara të orientuara drejt promovimit të barazisë gjinore, të tilla si:

Aktivitete	Buxheti
1. Vendorsja e një mekanizmi për sigurimin e të dhënave të ndara sipas gjinisë në programet dhe raportet që shqyrtohen nga këshilli	-
2. Forcimi i vetëdijes tek gratë për kujdes të vazhdueshëm dhe mbrojtje të shëndetit të tyre; Mamografi falas për 100 gra që janë të sëmura dhe kanë simptoma të kancerit të gjirit (duke përfshirë të gjitha etnitë dhe vendbanimet urbane dhe rurale)	100.000 denarë
3. Vendorsja e një mekanizmi për monitorimin e rezultateve të barabarta gjinore	-
4. Projekt për rritjen e ndërgjegjësimit tek gratë dhe burrat – Mbështetje financiare për strehimore për gra dhe vajza që janë viktime të dhunës në familje, në bashkëpunim me organizata joqeveritare dhe institucione lokale.	900.000 denarë
4.1. Parandalimi dhe ndikimi në uljen e dhunës me bazë gjinore dhe dhunës në familje – Aktivitete konkrete gjatë fushatës 16-ditore, 25 nëntor – 10 dhjetor 2025.	60.000 denarë
5. Analizë gjinore e përfituesve të programeve: sport, mbrojtje sociale, kulturë, etj	-
6. Aktivitete tjera të pa parashikueshme	100.000 denarë
Vlera totale e mjeteve	1.160.000 denarë

Edhe pse aktivitetet e përmendura janë të ndjeshme, sensitive nga perspektiva gjinore dhe janë të orientuara drejt përmirësimit të pozitës së grave, analiza tregon se interseksionalisht janë të verbra. Masat nuk përmbajnë informacione të sakta se cilat nëngrupe të grave dhe vajzave synohen, dhe as nuk bazohen në një analizë sistematike të nevojave specifike të grave më të cënueshme, siç janë gratë dhe vajzat me aftësi të kufizuara, gratë nga zonat rurale, gratë nga komunitete të ndryshme etnike, gratë me status të ulët socio-ekonomik ose me nivel më të ulët arsimimi.

Për shembull, tek aktiviteti për mamografi falas thuhet se përfshihen të gjitha etnitë dhe vendbanimet urbane dhe rurale, megjithatë indikatorët e përcaktuar janë të kufizuar vetëm në numrin total të grave që kanë kërkuar shërbime mjekësore. Mungojnë indikatorë që do të

mundësonin ndjekjen nëse vërtet janë përfshirë gra nga zonat rurale, gra rome, gra me aftësi të kufizuara apo gra me qasje të vështirësuar në shërbimet shëndetësore. Në këtë mënyrë, aspekti interseksional mbetet vetëm i përmendur në mënyrë deklarative, pa operacionalizim thelbësor.

Në mënyrë të ngjashme, tek masat për parandalimin dhe mbrojtjen nga dhuna me bazë gjinore dhe dhuna në familje, nuk përmenden qasje të veçanta për grupe të ndryshme të grave, edhe pse dihet se rreziket, barrierat për raportim dhe qasja në shërbime ndryshojnë ndjeshëm tek gratë me aftësi të kufizuara, gratë nga zonat rurale dhe gratë nga komunitete etnike të marginalizuara.

Analiza gjinore nuk duhet të bazohet vetëm në të dhëna të ndara sipas gjinisë (gra dhe burra), por duhet të përfshijë edhe karakteristika të tjera relevante identitare dhe socio-ekonomike, si mosha, vendi i banimit (urban/rural), përkatësia etnike, aftësia e kufizuar, arsimi dhe statusi ekonomik.¹¹ Vetëm përmes një qasjeje të tillë interseksionale mund të sigurohet që masat t'u përgjigjen vërtet nevojave të ndryshme të grave dhe vajzave dhe të kontribuojnë në uljen e pabarazive ekzistuese.

Përveç kësaj, një problem tjetër është fakti që mbledhja e statistikave gjinore është paraparë si aktivitet ex post, përkatësisht ndodh pasi mjetet buxhetore janë shpenzuar, gjë që nuk garanton se ato janë përdorur në mënyrë të përgjegjshme nga perspektiva gjinore.

5.2. ANALIZA E PROGRAMIT PËR AKTIVITETET NË FUSHËN E MBROJTJES SOCIALE, SHËNDETËSORE DHE TË FËMIJËVE PËR VITIN 2025.

Programi përfshin masa të shumta që synojnë mbështetjen e kategorive të cënueshme sociale, duke përfshirë fëmijët, personat me aftësi të kufizuara, personat me shëndet të dëmtuar dhe grupe të tjera të marginalizuara. Edhe pse programi njeh forma të ndryshme të rrezikut social, perspektiva gjinore dhe qasja interseksionale nuk janë të integruara në mënyrë sistematike.

Programi parasheh aktivitete me karakter informativ dhe mbështetës:

Sfera	Aktivitete	Buxheti
ZBATIMI I AKTIVITETEVE DHE MANIFESTIMI I DATËVE TË RËNDËSISHME NË FUSHËN SOCIALE	2- Prill, Dita Botërore e Autizmit , 21 - Mars, Dita Botërore e të gjithë fëmijëve që vuajnë nga Sindroma Daun. Tetori Rozë, muaji për ngritjen e vetëdijes për kancerin e gjirit, përfshirë edhe aktivtete tjera të pa parashikueshme	600.000 denarë

¹¹ KNBG, Polio Plus dhe ADI, *Udhëzues për qasje interseksionale gjinore, 2025*.

MBROJTJA FËMIJËVE	E	Fëmijë me probleme arsimore dhe sociale; Fëmijë pa prindër dhe kujdes prindëror; -Fëmijë në rrugë; -Fëmijë të prindërve të vetëm; -Fëmijë me aftësi të kufizuara intelektuale dhe fizike; -Mbështetje financiare për arsimimin e nxënësve që janë në rrezik social ose kanë aftësi të kufizuara intelektuale dhe fizike; -Ndihmë në paketa me materiale shkollore për nxënësit me rrezik social; -Përfshirje aktive e fëmijëve në rrezik social në institucionet parashkollore, konkretisht cerdhet e qytetit; - Përfshirje aktive e fëmijëve romë në institucionet parashkollore dhe zvogëlimi i fenomenit të lypjes;	300.000 denarë
MBROJTJA SOCIALE		Persona në rrezik social, persona të pastrehë; -Personat që janë përfitues të ndihmës së caktuar që nuk janë në gjendje të punojnë ose u është hequr aftësia e tyre për të punuar; -Personat e moshuar dhe të dobët pa kujdes familjar; -Prindërit beqarë; -Personat që janë viktimat të dhunës në familje	300.000 denarë
MBROJTJA SHËNDETËSORE		- gjendje e përkeqësuar shëndetësore (kancer, tumore, etj.) - ndihmë financiare një herëshe për fëmijët dhe personat që vuajnë nga sëmundje të rralla dhe specifike, - ndihmë financiare një herëshe për të moshuarit dhe personat në gjendje të dobët shëndetësore dhe ekonomike për trajtim, - Ndihmë me ilaçe, - Ndihmë financiare për individët që kanë nevojë për ndërhyrje kirurgjikale në vend ose jashtë vendit - Ndihmë financiare për individët që vuajnë nga sëmundje të lehta, bazuar në raportet e spitalit - Ndihmë financiare për individët që vuajnë nga sëmundje kronike	400.000 denarë

	- Burime financiare për individët që i nënshtrohen rehabilitimit për trajtimin e varësisë nga droga.	
	Vlera totale e mjeteve	1.600.000 denarë

Në **fushën e mbrojtjes sociale**, aktivitetet për nga aspekti gjinor janë formuluar si neutrale dhe u referohen të gjithë qytetarëve pa dallim, me përjashtim të kategorive si prindërit e vetëm dhe viktimat e dhunës në familje. Megjithatë, nga një perspektivë interseksionale, edhe në këto dy kategori të ndjeshme gjinore, nuk merret parasysh pozita specifike e grave; përkatësisht programi nuk i njeh nëngrupet e grave me të cenueshme, si gratë dhe vajzat me aftësi të kufizuara, gratë nga zonat rurale, gratë nga komunitete të ndryshme etnike, gratë me status të ulët socio-ekonomik ose me nivel më të ulët arsimimi.

Në **fushën e mbrojtjes së fëmijëve**, programi përfshin disa kategori të cenueshme, përfshirë fëmijët romë dhe fëmijët me aftësi të kufizuara. Nga perspektiva gjinore dhe interseksionale, fëmijët trajtohen si një grup homogjen, pa ndarje sipas gjinisë dhe pa njohjen e rrezeve dhe nevojave të ndryshme të vajzave dhe djemve. Veçanërisht mungon një analizë e ndikimit të përkatësisë etnike dhe statusit socio-ekonomik mbi pabarazitë gjinore tek fëmijët. Megjithatë, nga aspekti interseksional, është pozitive që programi i njeh disa grupe, si fëmijët romë dhe fëmijët me aftësi të kufizuara, si kategori veçanërisht të cenueshme.

Në **fushën e mbrojtjes shëndetësore**, programi parashikon masa të drejtuara ndaj personave me gjendje shëndetësore të dëmtuar, duke përfshirë sëmundje malinje, fëmijë dhe persona me sëmundje të rralla dhe specifike, të moshuar dhe persona në gjendje të dobët shëndetësore dhe ekonomike, si dhe mbështetje për trajtim përmes sigurimit të barnave dhe ndihmës financiare për ndërhyrje kirurgjikale në vend ose jashtë vendit. Edhe pse këto masa u përgjigjen nevojave reale shëndetësore, ato nga perspektiva gjinore janë neutrale, përkatësisht u referohen të gjithë qytetarëve.

Prandaj, programet e ardhshme duhet të bazohen në një analizë gjithëpërfshirëse gjinore, të përfshijnë indikatorë interseksionalë dhe të sigurojnë alokime të përshtatshme buxhetore për mbështetje të synuar, të drejtë dhe të qëndrueshme për grupet më të cenueshme të grave dhe vajzave.

5.3. ANALIZA E PROGRAMIT PËR AKTIVITETET NË FUSHËN E SEKTORIT TË VEPRIMTARIVE PUBLIKE, DEPARTAMENTI PËR MBROJTJEN SHËNDETËSORE, SOCIALE DHE TË FËMIJËVE, DHE MBROJTJEN DHE SHPËTIMIN E QYTETARËVE DHE PASURIVE PËR VITIN 2025.

Programi është kryesisht i orientuar drejt përmirësimit të sigurisë teknike dhe infrastrukturore në objektet publike, veçanërisht në institucionet arsimore dhe cerdhe. Aktivitetet fokusohen në parandalimin e zjarreve dhe rreziqeve teknike përmes mirëmbajtjes së pajisjeve kundërzjarrit, instalimeve elektrike dhe sistemeve të ngrohjes, si dhe mbështetjes së organizatave vullnetare kundërzjarrit.

Edhe pse programi në mënyrë indirekte kontribuon në sigurinë e të punësuarve, nxënësve dhe fëmijëve, ai nuk përmban një analizë të qartë gjinore dhe nga perspektiva gjinore janë neutrale.

Nga perspektiva interseksionale, programi nuk i njeh nevojat specifike të nëngrupeve që mund të jenë në rrezik të shtuar, si fëmijët dhe personat me aftësi të kufizuara, gratë e punësuar në institucionet arsimore, personat me mobilitet të kufizuar, fëmijët nga zonat rurale dhe anëtarët e komuniteteve etnike më të vogla. Nuk analizohet përshtatshmëria e infrastrukturës dhe masave të sigurisë për këto grupe, veçanërisht në raste evakuimi dhe shpëtimi.

Për më tepër, edhe pse parashikohet mbështetje për organizatat vullnetare kundër zjarrit, nuk shqyrtohet struktura e tyre gjinore, as nuk parashikohen masa për të inkurajuar pjesëmarrjen e grave në sektorin e mbrojtjes dhe shpëtimit, përkatësisht nuk është zbatuar qasje transformuese gjinore.

Investimet kapitale në cerdhe dhe në mbrojtjen sociale kanë potencialin të kontribuojnë në mënyrë të konsiderueshme në uljen e barrës së pashpërblyer të kujdesit, e cila kryesisht bie mbi gratë, dhe në rritjen e pjesëmarrjes së tyre në tregun e punës. Megjithatë, këto investime nuk shoqërohen me një analizë gjinore dhe interseksionale.

Aktivitete	Buxheti
Shërbim i rregullt, mirëmbajtje e aparatëve për fikjen zjarrit dhe hidrantëve në Komunë dhe komunitetet urbane dhe lokale, shkollat e mesme, shkollat fillore dhe cerdhet.	150.000 denarë
Testimi dhe mirëmbajtja e mbrojtjes nga rrufeja dhe tokëzimit mbrojtës, testimi i rezistencës së tokëzimit mbrojtës të instalimeve elektrike me tension të ulët, testimi i rezistencës izoluese të instalimeve elektrike me tension të ulët në komunë, komunitetet urbane dhe lokale, shkolla të mesme, shkolla fillore dhe cerdhe;	360.000 denarë
Mirëmbajtja e oxhaqeve, pajisjeve të shkarkimit të tymit dhe kazanëve të ngrohjes qendrore në objektet e shkollave fillore dhe të mesme.	50.000 denarë

Organizata vullnetare kundër zjarrit që do të veprojnë në territorin e Komunës së Gostivarit.	100.000 denarë
Aktivitete tjera të paparashikueshme	-
Vlera totale e mjeteve	660.000 denarë

Shënim: Brenda këtij programi janë parashikuar edhe aktivitete të tjera, të cilat nuk janë marrë parasysh në këtë analizë, pasi në këtë rast nuk përbëjnë objekt studimi.

5.4. ANALIZA E PROGRAMIT TË AKTIVITETEVE NË FUSHËN E ARSIMIT NË VITIN 2025.

Programi për arsim për nga perspektiva gjinore është neutral, që do të thotë se nuk përmban analizë të qartë gjinore dhe nuk bazohet në një qasje interseksionale. Në program nuk përmendet se gjatë përgatitjes janë marrë parasysh nevojat, përvojat dhe pozicionet e ndryshme të grave dhe burrave, as nuk përdoren të dhëna të ndara sipas gjinisë si bazë për planifikimin e masave dhe alokimeve buxhetore.

Sipas tabelës së financimit të Programit për Arsim të Komunës së Gostivarit për vitin 2025, pjesa më e madhe e fondeve është e destinuar për funksionimin e përditshëm të sistemit arsimor, ku dominojnë pagesat për paga dhe kompensime. Këto fonde, kryesisht të siguruar përmes subvencioneve nga buxheti qendror, janë të destinuara për të siguruar vazhdimësinë e funksionimit të shkollave fillore dhe të mesme, siç paraqiten në tabelë:

Arsim	
Arsim fillor	
Paga dhe kompensime	606.500 denarë
Mallra dhe shërbime	42.108.000 denarë
Subvencione dhe transfere	8.800.00 denarë
Investime kapitale	700.000 denarë

Arsim	
Arsim i mesëm	
Paga dhe kompensime	302.900 denarë
Mallra dhe shërbime	41.150.000 denarë
Subvencione dhe transfere	8.800.00 denarë
Investime kapitale	00
Investime kapitale	10.000.000 denarë
Dotacione	320.000.000 denarë



Vetëfinancim	140.500.000 denarë
--------------	--------------------

Mjetet financiare të lidhura me arsimin mund të klasifikohen si të drejtuara në mënyrë indirekte drejt grave, duke pasur parasysh se pjesa më e madhe e stafit mësimor në arsimin fillor dhe të mesëm përbëhet nga gra. Nga ky këndvështrim, programi ka një efekt pozitiv mbi sigurinë ekonomike të grave të punësuar në arsim. Megjithatë, një qasje e tillë mbetet e kufizuar, pasi nuk parashikohen aktivitete apo masa që do të kontribuonin në uljen e stereotipeve gjinore në sektorin arsimor.

Nga aspekti interseksional, programi nuk identifikon grupe specifike nxënësish dhe punonjësish që mund të përballen me forma të shumta të cenueshmërisë, si fëmijët nga zonat rurale, fëmijët me aftësi të kufizuara, nxënësit nga familje me status socio-ekonomik më të ulët apo nxënësit nga komunitete etnike më të vogla. E vetmja qëllim që potencialisht lidhet me aspektin interseksional është mbledhja e të dhënave për nxënësit që udhëtojnë drejt shkollave, lidhjet dhe shpenzimet e tyre, gjë që mund të shërbejë si bazë për analizën e qasjes në arsim, por ky qëllim nuk është zhvilluar më tej nga aspekti gjinor ose social.

Edhe pse programi parashikon një sërë aktiviteteve edukative (ditë të shënuara botërore, konkurse, vizita dhe fushata), ato janë formuluar si aktivitete universale, pa grupe të qarta targeti, objektiva gjinore ose indikator të matshëm. Prandaj, potenciali i tyre për të kontribuar në përmirësimin e barazisë gjinore dhe përfshirjes sociale mbetet i kufizuar dhe i vështirë për t'u matur.

Është e nevojshme buxhetim i përgjegjshëm gjinor, që do të thotë të reflektojë nevojat specifike të grave dhe burrave, si dhe nevojat e grupeve të ndryshme të grave dhe burrave (sipas përkatësisë etnike, aftësisë, moshës, vendbanimit në zonë urbane/rurale, përkatësisë ndaj pakicave seksuale etj.). Thjeshtuar, një buxhet i përgjegjshëm gjinor është ai në të cilin është përfshirë perspektiva gjinore. Kjo nënkupton vlerësim gjinor të buxhetit, me përfshirjen e perspektivës gjinore në të gjitha nivelet e procesit buxhetor dhe ristrukturimin e të ardhurave dhe shpenzimeve me qëllim promovimin e barazisë gjinore.¹²

Në lidhje me politikat publike, nga këndvështrimi i ndikimit të tyre (efekti përfundimtar) mbi gratë dhe burrat, tabela ilustron shembuj, si sipas llojeve të politikave, ashtu edhe nga perspektiva interseksionale, konkretisht për masat që mund të përmirësojnë pozitën e grave.

Llojet e politikave	Analiza e masave konkrete nga perspektiva interseksionale
---------------------	---

¹² KNBG, Polio Plus dhe ADI, *Udhëzues për qasje interseksionale gjinore*, 2025.

Politikat dhe ndërhyrjet, nga aspekti gjinor neutral u referohen të gjithë qytetarëve, pa dallim në bazë të gjinisë.	Shumica e masave të parashikuara në programet e Komunës së Gostivarit nga aspekti gjinorë janë neutrale, dmth u referohen të gjithë qytetarëve, pa dallim në bazë të gjinisë. Aktivitetet në fushën e arsimit, shëndetësisë dhe shërbimeve sociale nuk bëjnë dallim midis grave dhe burrave dhe nuk marrin parasysh se si dhe në çfarë mënyre grupet e ndryshme të grave, veçanërisht ato me forma të shumta të cenueshmërisë, mund të përfitojnë nga masat. Ky qasje kufizon potencialin e programeve për t'iu përgjigjur nevojave specifike të grave dhe vajzave.
Politikat dhe ndërhyrjet, nga aspekti gjinor të verbra nuk bëjnë dallim midis grave dhe burave dhe nuk synojnë të reduktojnë hendekun ekzistues gjinor.	Shumica e masave të propozuara në programet janë interseksionalisht të verbëra, dmth nuk bëjnë dallim midis grave dhe burrave dhe nuk i njohin nevojat specifike të grupeve të ndryshme të grave dhe burrave.
Politikat dhe ndërhyrjet e përgjegjshme gjinore i njohin dallimet dhe karakteristikat që rrjedhin nga rolet gjinore, duke siguruar që efektet e tyre të promovojnë barazinë gjinore.	Në programet e analizuara nuk identifikohen qartë politika të përgjegjshme gjinore. Edhe pse disa aktivitete (si investimet në cerdhe ose aktivitete të lidhura me shëndetin e grave) kanë potencial për të ndikuar pozitivisht tek gratë, ato nuk bazohen në analizë gjinore dhe nuk shoqërohen me tregues gjinorë dhe interseksionalë. Si rezultat, nuk mund të vërtetohet nëse masat realisht i përgjigjen nevojave të grave dhe nëse kontribuojnë në uljen e pabarazive ekzistuese.
Politikat dhe ndërhyrjet specifike gjinore, synojnë të krijojnë një shpërndarje të drejtë të burimeve, duke adresuar nevojat e ndryshme të grave dhe burrave.	Masat specifike gjinore, të cilat drejtpërdrejt synojnë përmirësimin e pozitës së grave, pothuajse nuk janë të pranishme në programet e analizuar. Edhe pse disa nga aktivitetet formalisht i referohen grave, ato nuk përbëjnë ndërhyrje specifike gjinore në kuptimin thelbësor, pasi nuk bazohen në një analizë gjinore, nuk shoqërohen me alokime buxhetore të përshtatshme dhe nuk mundësojnë efekte të matshme mbi përmirësimin e pozitës së grave. Mungesa e një qasjeje të tillë do të thotë se programet mbeten në nivel deklarativ dhe nuk shfrytëzojnë potencialin e tyre për mbështetje të synuar dhe të drejtë të grave, veçanërisht të atyre që përballen me forma të shumta të cenueshmërisë.
Politikat dhe ndërhyrjet gjinore me qasje transformuese kanë për qëllim të ndryshojnë shpërndarjen ekzistuese të pushtetit, burimeve dhe përgjegjësi, në mënyrë që të krijohen	Në programet e Komunës së Gostivarit nuk identifikohen politika transformuese gjinore. Nuk ekzistojnë masa që synojnë ndryshimin e roleve dhe stereotipeve ekzistuese gjinore. Mungesa e këtyre


marrëdhënie të barabarta midis grave dhe burrave, duke u fokusuar në nevojat strategjike dhe duke synuar ndikim dhe ndryshime në afat të gjatë.

ndërhyrjeve tregon se programet nuk shfrytëzojnë potencialin e tyre për të transformuar në mënyrë afatgjatë marrëdhëniet gjinore në nivel lokal.

5. ANALIZA E PËRDORUESVE (ANKETA ME QYTETARËT)


Me qëllim që të sigurohet një pamje më e gjerë mbi përvojat e qytetarëve të Komunës së Gostivarit lidhur me qasjen, përdorimin dhe cilësinë e shërbimeve në arsimin, shëndetësinë dhe mbrojtjen sociale, u realizua një anketë online me qytetarët. Pyetësi është dizajnuar për të mundësuar mbledhjen e të dhënave mbi përvojat personale, perceptimet dhe qëndrimet e qytetarëve, si dhe rekomandimet e tyre për përmirësimin e qasjes në shërbime dhe avancimin e barazisë gjinore në këto fusha.

Пол
100 responses




Grafikoni 1, Gjinia e të anketuarve

Në lidhje me gjininë e të anketuarve të përfshirë në pyetësor, 58% (58) janë gra dhe 42% (42) janë burra.


Возраст
100 responses*Grafikoni 2, Struktura sipas moshës e të anketuarve*

Struktura sipas moshës e qytetarëve të përfshirë në studim, nga gjithsej 100 të anketuar, tregon se pjesa më e madhe, ose 50% (50), i përket grupmoshës 30–44 vjeç. Grupi tjetër më i madh është ai 45–59 vjeç, i cili përbën 29% (29) të të anketuarve. Grupi 18–29 vjeç përfaqësohet me 14% (14), ndërsa pjesa më e vogël, 7% (7), janë mbi 60 vjeç.

Највисоко завршено образование
100 responses*Grafikoni 3 Struktura arsimore e të anketuarve,*

Në lidhje me strukturën arsimore të të anketuarve, pjesa më e madhe ka arsim të lartë, ose 51% (51). Më pas vijnë të anketuarit me arsim të mesëm me 30% (30), ndërsa 18% (18) kanë përfunduar studime master. Pjesa më e vogël, 1% (1), ka përfunduar studime e doktoraturës.

Етничка припадност
100 responses




Grafikoni 4, Struktura etnike e të anketuarve

Në lidhje me strukturën etnike të të anketuarve, pjesa më e madhe janë shqiptarë, ose 53% (53). Më pas vijnë maqedonasit me 30% (30), ndërsa 12% (12) e të anketuarve janë turq. Pjesa më e vogël, 5% (5), janë romë.

Kjo strukturë etnike e të anketuarve është veçanërisht e rëndësishme nga aspekti interseksional, pasi mundëson analizën e qasjes në arsim, shëndetësi dhe mbrojtje sociale përmes prizmit të përkatësisë etnike, në kombinim me faktorë të tjerë si gjinia, mosha, vendi i banimit dhe statusi socio-ekonomik. Përfaqësimi i disa komuniteteve etnike, përfshirë grupet më të vogla dhe të marginalizuara, si romët, mundëson identifikimin e dallimeve dhe pabarazive të mundshme në përdorimin e shërbimeve. Edhe pse disa grupe janë më pak të përfaqësuara në mostër, pjesëmarrja e tyre është e rëndësishme për të kuptuar sfidat specifike me të cilat përballen, duke kontribuar në një analizë interseksionale më gjithëpërfshirëse dhe më të ndjeshme.


Дали сте вработени?
100 responses



Grafikoni 5, Statusi i punësimit së të anketuarve

Në lidhje me statusin e punësimit të të anketuarve, rezultatet tregojnë se 38% (38) prej tyre janë të punësuar në sektorin privat. Më pas vijnë të punësuarit në sektorin publik me 33% (33). Një pjesë e të anketuarve, 23% (23), janë të papunë, ndërsa pjesa më e vogël, 6% (6), janë vetëpunësuar.


Место на живеење
100 responses



Grafikoni 6, Vendbanimi i të anketuarve

Në lidhje me vendin e banimit të të anketuarve, shpërndarja është e barabartë, ku 50% (50) jetojnë në zona urbane dhe 50% (50) në zona rurale.

Социо-економски статус (самооценка)
100 responses



Grafikon 7, Statusi socio-ekonomik i të anketuarve


Në lidhje me statusin socio-ekonomik të të anketuarve, 70% (70) e tyre, bazuar në vetëvlerësim, deklaruan se i përkasin statusit socio-ekonomik mesatar. Më pas, 19% (19) e të anketuarve deklaruan se janë me status socio-ekonomik të ulët, ndërsa pjesa më e vogël, 11% (11), deklaruan se i përkasin statusit socio-ekonomik të lartë.

Struktura e larmishme socio-demografike e të anketuarve mundëson kryerjen e një analize gjithëpërfshirëse gjinore dhe interseksionale të qasjes në arsim, shëndetësi dhe mbrojtje sociale në

Komunën e Gostivarit. Përfaqësimi i personave nga grupmosha të ndryshme, nivele arsimore, komunitete etnike, status socio-ekonomik, si dhe nga zonat urbane dhe rurale, mundëson shqyrtimin e ndërthurjes së faktorëve të ndryshëm që ndikojnë në përvojat e qytetarëve gjatë përdorimit të shërbimeve publike.

Kjo larmi është veçanërisht e rëndësishme për identifikimin e pabarazive të mundshme dhe barrierave strukturore me të cilat përballen grupet e ndryshme të qytetarëve, veçanërisht gratë dhe kategoritë e tjera të cenueshme. Një qasje e tillë interseksionale kontribuon në një kuptim më të thellë të formave komplekse të pabarazisë dhe përfaqëson një bazë të fortë për formulimin e politikave dhe masave lokale më gjithëpërfshirëse dhe përgjegjëse ndaj gjinive.


1. Дали вие или член на вашето семејство во последните 3 години сте користеле услуги од следниве области? (може повеќе одговори)
100 responses



Analiza e pyetjes “ Ju ose një anëtar i familjes suaj, a keni përdorur gjatë tre viteve të fundit shërbime nga fushat e mëposhtme?”, ku të anketuarit mund të zgjedhnin më shumë se një përgjigje, tregon se shërbimet shëndetësore janë përdorur më së shumti. Konkretnisht, nga gjithsej 100 të anketuar, në 82 raste u përmend përdorimi i shërbimeve shëndetësore. Më pas vjen përdorimi i shërbimeve arsimore, i cili u përmend në 65 raste, ndërsa shërbimet e mbrojtjes sociale u përmendën në 57 raste.

2. Како го оценувате пристапот до овие услуги во Општина Гостивар?


100 responses



Analiza e pyetjes “Si e vlerësoni qasjen në këto shërbime në Komunën e Gostivarit?” tregon se perceptimet e qytetarëve janë të ndara. Pjesa më e madhe e të anketuarve, 43% (43), e vlerësojnë qasjen në shërbime si mesatare, ndërsa 36% (36) e konsiderojnë qasjen të mirë. Për më tepër, 16% (16) e të anketuarve e vlerësojnë qasjen si të keqe, dhe vetëm 5% (5) e shohin qasjen në shërbime si shumë të mirë. Këto rezultate tregojnë se një pjesë e konsiderueshme e qytetarëve nuk është plotësisht e kënaqur me qasjen në shërbimet arsimore, shëndetësore dhe sociale në nivel lokal.

3. Дали Вие сте се соочиле со потешкотии при користење на некоја од овие услуги?

100 responses




Analiza e pyetjes “A keni hasur vështirësi gjatë përdorimit të ndonjë prej këtyre shërbimeve?” tregon se pjesa më e madhe e të anketuarve, 68% (68), janë përgjigjur pozitivisht, duke treguar se janë përballur me vështirësi gjatë përdorimit të shërbimeve në arsim, shëndetësi dhe mbrojtje sociale. Në kontrast, 32% (32) e të anketuarve kanë deklaruar se nuk kanë hasur vështirësi gjatë përdorimit të këtyre shërbimeve.

Ky përqindje e lartë e të anketuarve që raportojnë vështirësi në përdorimin e shërbimeve publike në nivel lokal sugjeron se shërbimet nuk janë të njëjtë të aksesueshme dhe të përshtatura për

nevojat e të gjithë qytetarëve, gjë që thekson më tej nevojën për përmirësim të tyre përmes një qasjeje sensitive, ndjeshme gjinore dhe interseksionale.

Доколку одговоривте со „Да“, наведете во која област:


70 responses



Për të anketuarit që në pyetjen e mëparshme janë përgjigjur pozitivisht, përkatësisht se janë përballur me vështirësi gjatë përdorimit të shërbimeve, u parashtrua një pyetje shtesë me qëllim identifikimin e saktë të fushës ku shfaqen këto vështirësi, ku të anketuarit mund të zgjedhnin më shumë se një përgjigje. Analiza tregon se nga gjithsej 100 të anketuar, në 57 raste u përmendën vështirësi gjatë përdorimit të shërbimeve shëndetësore, duke treguar se shëndetësia është sektori me barrierat më të shprehura për qytetarët. Më pas vijnë shërbimet e mbrojtjes sociale, të cilat u përmendën në 37 raste, ndërsa arsimi u identifikua si fushë problematike në 34 raste.

4. Според вас, кои фактори најмногу го отежнуваат пристапот до услугите? (може повеќе одговори)

100 responses




Analiza e pyetjes “Cilat faktorë e vështirësojnë qasjen në shërbime?”, ku të anketuarit mund të zgjedhnin më shumë se një përgjigje, tregon për barrierat multidimensionale me të cilat përballen qytetarët. Konkretisht, nga gjithsej 100 të anketuar, në 65 raste si faktor më i rëndësishëm u përmendën procedurat komplekse administrative, që tregon për pengesa institucionale në realizimin e të drejtave. Mungesa e informacionit u identifikua në 60 raste, ndërsa mungesa e

procedurave të përshtatshme dhe të qarta u përmend në 58 raste. Shpenzimet financiare u përmendën në 30 raste, largësia dhe problemet me transportin në 26 raste, ndërsa arsyet sociale dhe kulturore u përmendën në 22 raste.

Në tërësi, këto gjetje theksojnë nevojën për thjeshtimin e procedurave administrative, përmirësimin e informimit dhe sigurimin e një qasjeje të ndjeshme sensitive gjinore dhe kulturore në dizajnimin dhe zbatimin e shërbimeve publike, me qëllim uljen e pabarazive interseksionale ekzistuese në qasjen në shërbimet shëndetësore, arsimore dhe sociale.

5. Дали сметате дека жените и мажите имаат еднаков пристап до образование, здравство и социјална заштита во Општината?


100 responses




Analiza e pyetjes “A mendoni se gratë dhe burrat kanë qasje të barabartë në arsim, shëndetësi dhe mbrojtje sociale?” tregon se shumica e të anketuarve, 58% (58), mendojnë se ekzistojnë pabarazi, ndërsa 42% (42) besojnë se qasja është e barabartë. Këto rezultate tregojnë për ekzistencën e pabarazive gjinore të perceptuara në përdorimin e shërbimeve publike, çka është e rëndësishme për të kuptuar perceptimin e qytetarëve mbi barazinë gjinore në nivel lokal.

6. Дали според вас одредени групи жени имаат поголеми потешкотии во пристапот до услугите?

100 responses



Analiza e pyetjes “A kanë disa grupe të grave më shumë vështirësi në qasjen në shërbime?” tregon se shumica e të anketuarve, 85% (85), mendojnë se disa grupe grave përballen me barriera më të madha, ndërsa 15% (15) konsiderojnë se nuk ekzistojnë të tilla dallime. Kjo përqindje e lartë tregon për një pabarazi të perceptuar strukturore, ku disa kategori të grave janë më të cenueshme ndaj kufizimeve gjatë përdorimit të shërbimeve publike.



Për të anketuarit që në pyetjen e mëparshme kanë përgjigjur pozitivisht se disa grupe të grave përballen me barriera më të madha në qasjen për përdorimin e shërbimeve publike, u parashtua një pyetje shtesë me qëllim identifikimin e grupeve konkrete të grave që janë më të prekura. Të anketuarit mund të zgjedhnin më shumë se një përgjigje, duke mundësuar një vështrim të detajuar nga një qasje interseksionale.


Analiza tregon se nga gjithsej 100 të anketuar, shpesh u përmendën gratë nga zonat rurale si ato që përballen më shumë me vështirësi (71 raste), të ndjekura nga gratë me aftësi të kufizuara (46), gratë nga komunitetet etnike më të vogla (45), gratë e moshuara (41), nënat beqare (28), si dhe gratë nga komuniteti rom dhe shqiptar, si dhe gratë me besim mysliman.

Analiza interseksionale zbulon më tej se grupet më të cenueshme janë gratë nga zonat rurale, anëtare të komuniteteve etnike më të vogla, nënat beqare dhe gratë me aftësi të kufizuara. Këto grupe shpesh përballen me barrierë të shumta – gjeografike (largësi dhe transport), sociale dhe kulturore, kufizime financiare dhe mungesë informacioni – të cilat në kombinim me dimensionin gjinor krijojnë një strukturë komplekse pabarazie.

Kjo thekson rëndësinë e përdorimit të një qasjeje interseksionale në planifikimin dhe përmirësimin e qasjes në shërbimet arsimore, shëndetësore dhe sociale, për të siguruar mundësi më të barabarta për të gjitha gratë, veçanërisht ato kategoritë më të cenueshme.

Në këtë drejtim, vlerësohet pozitivisht hapja e qendrës së strehimit në Gostivar për gratë viktime të dhunës familjare, si dhe krijimi i një rrjeti të larmishëm të shërbimeve sociale për mbështetjen e të moshuarve përmes organizatave qytetare. Këto iniciativa jo vetëm që adresojnë nevojat specifike të grupeve të cenueshme, por gjithashtu reflektojnë rolin potencial të politikave të ndjeshme gjinore dhe të orientuara interseksionalisht në kontekst lokal.


7. Дали знаете каде и како можете да поднесете поплака доколку сте незадоволни од услугите?
100 responses



Analiza e pyetjes “A e din qytetari se ku dhe si mund të parashtrojë ankesë nëse nuk është i kënaqur me shërbimet?” tregon se pjesa më e madhe e të anketuarve, 68% (68), janë të njohur me procedurën për parashtimin e ankesave, ndërsa 32% (32) nuk janë të informuar për këtë mundësi.

8. Дали сметате дека општината доволно ги зема во предвид родовата перспектива, односно потребите на жените и девојките при планирање на услугите?

100 responses



Analiza e pyetjes “A mendoni se komuna merr mjaftueshëm parasysh perspektivën gjinore, pra nevojat e grave dhe vajzave gjatë planifikimit të shërbimeve?” tregon se pjesa më e madhe e të anketuarve, 50% (50), mendojnë se perspektiva gjinore është pjesërisht e integruar, pra merr parasysh vetëm pjesërisht nevojat e grave dhe vajzave; 42% (42) mendojnë se komuna nuk i merr parasysh këto nevoja, ndërsa vetëm 8% (8) konsiderojnë se nevojat e grave dhe vajzave merren në mënyrë adekuate parasysh gjatë planifikimit të shërbimeve.

Këto rezultate tregojnë perceptimin dominues tek të anketuarit se komuna gjatë planifikimit të shërbimeve nuk i merr mjaftueshëm parasysh nevojat e grave dhe vajzave. Një perceptim i tillë tregon për ekzistencën e mangësive strukturore në integrimin e perspektivës gjinore në proceset e planifikimit dhe sigurimit të shërbimeve publike. Për këtë arsye, theksohet nevoja që komuna ta përfshijë sistematikisht dhe me përkushtim perspektivën gjinore, me qëllim sigurimin e një qasjeje të barabartë dhe gjithëpërfshirëse në shërbime për të gjithë qytetarët, veçanërisht për kategoritë e cenueshme.

Analiza e përgjigjeve të hapura në pyetjen “**Cilat masa, sipas mendimit tuaj, do të kontribuonin në përmirësimin e barazisë gjinore dhe zbatimin e qasjes interseksionale në arsim, shëndetësi dhe mbrojtje sociale?**” tregon një nevojë të qartë dhe të qëndrueshme për të futur masa sistematike, të koordinuara dhe afatgjata në të tri sektorët e analizuar.

Në fushën e **shëndetësisë**, një pjesë e konsiderueshme e përgjigjeve tregojnë për barriera serioze me të cilat përballen gratë, veçanërisht ato nga zonat rurale dhe të largëta, nënat beqare, gratë me aftësi të kufizuara dhe gratë nga disa komunitete fetare dhe etnike. Mungesa e institucioneve



shëndetësore, e personelit mjekësor dhe e transportit publik në zonat rurale, si dhe mungesa e shërbimeve të specializuara në nivel lokal, i detyron gratë të udhëtojnë drejt qendrave më të mëdha, gjë që e vështirëson më tej qasjen në kujdesin shëndetësor. Theksohet veçanërisht nevoja për një qasje të ndjeshme sensitive gjinore dhe kulturore në shëndetësi, duke përfshirë sigurimin e kushteve të përshtatshme për respektimin e bindjeve fetare dhe personale të pacientëve.

Në fushën e **arsimit**, të anketuarit theksojnë nevojën për krijimin e ambienteve shkollore të sigurta dhe gjithëpërfshirëse, integrimin e perspektivës gjinore dhe interseksionale në programet mësimore, si dhe trajnim të vazhdueshëm për stafin mësimor dhe profesional për njohjen dhe tejkalimin e stereotipeve gjinore, diskriminimit dhe përjashtimit. Vëmendje e veçantë i kushtohet përmirësimit të qasjes për fëmijët me aftësi të kufizuara, si në aspektin e infrastrukturës, ashtu edhe në përshtatjen e metodave mësimore dhe kushteve të të nxënës.

Në fushën e **mbrojtjes sociale**, përgjigjet tregojnë për procedura administrative komplekse, mungesë informacioni, periudha të gjata për realizimin e të drejtave dhe kapacitete të kufizuara të shërbimeve, gjë që prek veçanërisht kategoritë e cenueshme, si nënat beqare, gratë nga zonat rurale dhe gratë me status socio-ekonomik të ulët. Të anketuarit theksojnë nevojën për informim më të mirë të përdoruesve dhe përf forcimin e kapaciteteve të ofruesve të shërbimeve sociale për zbatimin e një qasjeje të ndjeshme gjinore dhe interseksionale.

Nga një perspektivë interseksionale, përgjigjet tregojnë qartë se pabarazitë shpesh rrjedhin nga ndërthurja e faktorëve të ndryshëm: gjinia, vendi i banimit, përkatësia etnike dhe fetare, statusi socio-ekonomik, gjendja familjare dhe aftësia e kufizuar. Për këtë arsye, të anketuarit rekomandojnë që komuna gjatë krijimit të politikave dhe shpërndarjes së buxhetit të kryejë analiza të rregullta gjinore dhe interseksionale, në mënyrë që mjetet të drejtohen drejt nevojave reale të grupeve të ndryshme të grave dhe burrave.

Në këtë drejtim, vlerësohen pozitivisht iniciativat ekzistuese, si hapja e një qendre strehimi për gratë viktime të dhunës familjare në Gostivar dhe zhvillimi i një rrjeti shërbimesh sociale për të moshuarit përmes organizatave qytetare. Megjithatë, të anketuarit konsiderojnë të nevojshme përf forcimin e mëtejshëm të koordinimit institucional, ndjeshmërinë gjinore të punonjësve të sektorit publik, zbatimin e fushatave informative dhe përmirësimin e infrastrukturës dhe



shërbimeve mobile, për të siguruar një qasje të barabartë, të aksesueshme dhe dinjitoze për të gjithë qytetarët.

PËRFUNDIME

1. Analiza tregon se politikat, programet dhe masat ekzistuese lokale në fushën e arsimit, shëndetësisë dhe mbrojtjes sociale në pjesën më të madhe në **aspekt gjinor janë neutrale**, pa njohje sistematike të nevojave të ndryshme të grave dhe burrave.
2. Në dokumentet programore **nuk përdoren të dhëna të ndara sipas gjinisë dhe interseksionale**, gjë që kufizon ndjeshëm planifikimin e shërbimeve bazuar në nevojat reale të përdoruesve.
3. **Mungesa e mbledhjes dhe përdorimit sistematik të të dhënave të ndara sipas gjinisë në tre sektorët e synuar.**
4. Në sektorin shëndetësor evidentohen **dobësi strukturore**, si mungesa e shërbimeve të specializuara dhe akses i pamjaftueshëm territorial, që prek në mënyrë disproporcionale gratë nga zonat rurale, gratë me status socio-ekonomik të ulët dhe gratë me aftësi të kufizuara.
5. Mungesa e kapaciteteve në institucionet parashkollore për kujdesin ndaj fëmijëve, gjë që ndikon në mënyrë indirekte në pjesëmarrjen e grave në tregun e punës.
6. Perceptimet e qytetarëve tregojnë për **qasje të kufizuara në informacion, procedura komplekse dhe largësi gjeografike** si faktorë kryesorë që thellojnë pabarazinë gjinore dhe interseksionale.
7. **Pozitivisht**, në fushën e mbrojtjes së fëmijëve vërehet njohja e fëmijëve romë dhe fëmijëve me aftësi të kufizuara si kategori të cenueshme
8. Pozitivisht, në fushën e mbrojtjes sociale vlerësohet hapja e Qendrës për strehim të viktimave të dhunës familjare (shelter-qendër).

9. Pozitivisht, vërehet prania e praktikave gjinore-transformative në mbrojtjen sociale, duke përfshirë pjesëmarrjen e burrave në sektor që tradicionalisht perceptohet si “aktivitet femëror”.

REKOMANDIME

- 1. Futja e një analize sistematike gjinore dhe interseksionale** – Komuna dhe institucionet përkatëse duhet të kryejnë detyrimisht analiza gjinore dhe interseksionale gjatë përgatitjes së të gjitha politikave, programeve dhe buxheteve, me qëllim identifikimin në kohë të nevojave specifike të grupeve të ndryshme të grave dhe burrave.
- 2. Mbledhja dhe përdorimi i të dhënave të ndara sipas gjinisë dhe interseksionale** – Të vendoset detyrimi për mbledhjen e rregullt të të dhënave të ndara sipas gjinisë, moshës, përkatësisë etnike, vendbanimit, aftësisë së kufizuar dhe statusit socio-ekonomik, si dhe përdorimi i tyre aktiv gjatë planifikimit dhe monitorimit të masave.
- 3. Masat të targetuara për gratë më të cënueshme** – Të zhvillohen masa dhe shërbime të veçanta të drejtuara ndaj grave dhe vajzave me aftësi të kufizuara, grave nga zonat rurale, grave nga komunitetet etnike më të vogla, nënave beqare dhe grave viktime të dhunës, me alokime të përshtatshme buxhetore.
- 4. Përmirësimi i qasjes në shërbimet shëndetësore** – Të investohet në përmirësimin e infrastrukturës shëndetësore lokale dhe shërbimeve preventive, veçanërisht atyre që lidhen me shëndetin e grave.
- 5. Është e nevojshme rritja e kapaciteteve në institucionet parashkollore** dhe hapja e vendeve të reja për kujdesin ndaj fëmijëve, me qëllim përmirësimin e barazisë gjinore dhe rritjen e pjesëmarrjes së grave në tregun e punës.
- 6. Forcimi i kapaciteteve institucionale** – Të zhvillohen trajnime të vazhdueshme për punonjësit në arsimin, shëndetësinë dhe mbrojtjen sociale për barazinë gjinore dhe qasjen interseksionale, me fokus në njohjen dhe parandalimin e diskriminimit të drejtpërdrejtë dhe të tërthortë.
- 7. Koordinim më i mirë dhe përfshirja e sektorit qytetar** – Të forcohet bashkëpunimi me organizatat qytetare që punojnë me grupet e cënueshme, me qëllim targetimin më të mirë të masave dhe përgjigje më efikase ndaj nevojave reale të komunitetit.
- 8. Të gjitha programet dhe raportet vjetore** të publikohen si dokumente të veçanta në faqen e internetit të Komunës.



Co-funded by
the European Union



ПОЛИО ПЛУС
движење против хендикеп
www.polioplus.org.mk

